



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DIVJAKË
DREJTORIA E FINANCES DHE BUXHETIT

Nr. 1079/Prot,
/13

Divjakë, më: 12/02/2025

PROJEKT-VENDIM

Nr. 15, Datë 12/02/2025

PËR MBËSHTETJEN FINANCIARE TË NXËNËSVE ME ARRITJE TË SHKËLQYERA NË SHKOLLAT PUBLIKE TË BASHKISË DIVJAKË

Në mbështetje të Ligjit nr.139/2015 dt.17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, neni 8, neni 9, pika 1, nënpika 1.1, shkronja b, neni 23, pika 12, neni 24, neni 54, neni 55, Ligjit 69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar ne Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, neni 22, neni 23, neni 28, pika 4, shkronja b. Vendimi i Këshillit të Ministrave nr.632, datë 04.10.2004 “Për miratimin e dokumentit për politikën e decentralizimit në sektorin e arsimit parauniversitar”, I propozojmë Këshillit të Bashkisë Divjakë në mbledhjen e datës 24 / 02 / 2025:

Të Miratojë:

1. Mbështetjen Financiare për nxënësit me arritje të shkëlqyera që ndjekin arsimin e mesëm të ulët (klasa e 9-të) dhe arsimin e mesëm të lartë në shkollat publike të Bashkisë Divjakë, Sipas kriterëve të përcaktuara në këtë projekt-vendim.
2. Për përfitimin e mbështetjes financiare nga Bashkia Divjakë duhet që:
 - a. Nxënësit të mbarojnë vitin mësimor me të gjitha 10(dhjeta).
 - b. Të jenë nxënës të shkollave publike që ndjekin arsimin e mesëm të ulët dhe arsimin e mesëm të lartë.
3. Për përfitimin e mbështetjes financiare, nxënësit përfitues duhet të dorëzojnë dokumentacionin si më poshtë:
 - a. Deftese me vulë elektronike nga e-Albania për vitin parardhës.
 - b. Vërtetim nga drejtorja e shkollës për vazhdimin e vitit shkollor.
 - c. Çertifikatë personale me fotografi, e tre muajëve të fundit.
 - d. Çertifikatë e gjëndjes familjare.
4. Lista e Nxënësve me dhjeta e dërguar nga drejtoritë e shkollave të Bashkisë Divjakë, miratohet nga Drejtoria Arsimore Vendore.
5. Mbështetje Financiare në vitin mësimor për nxënësit e shkollave publike që ndjekin arsimin e mesëm të ulët është 10 000 (dhjetë mijë) lekë në vit/nxënës gjithashtu dhe për nxënësit që ndjekin arsimin e mesëm të lartë është 10 000 (dhjetë mijë) lekë në vit/nxënës.

6. Efektet financiare të këtij projekt-vendimi do të përfshihen në programin 09120 për nxënësit përfitues të arsimit të mesëm të ulët dhe në programin 09230 për nxënësit përfitues të arsimit të mesëm të lartë.
7. Për vitin 2025 fondi limit që do të shpërmdahet është 2 000 000 (dy milion) lekë dhe do të merret Të ardhurat e trashëguara nga viti 2024 në vitin 2025 për Bashkinë Divjakë.. Për vitet në vazhdim do të planifikohet si zë i veçantë në programet 09120 dhe 09230.
8. Në zbatim të këtij vendimi zyra për arsimin në Bashkinë Divjakë nxjerr udhëzimet përkatëse për organizimin dhe mënyrën e pagesës .

Përgjegjës i Sektorit Juridik, Prokurimeve Publike dhe Menaxhimit Aseteve

Andi BULLARI

Përgjegjës I buxhetit dhe MFK

Irena GJONI

Drejtore e Financës dhe Buxhetit

Xheladin BRAHKOLA

**KRYETARI
JOSIF GORREA**

